



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 104/02-17682//24
Kaçanik, 31.07.2024

PËR: Menaxhmentit dhe Bordit udhëheqës të KRU "Bifurkacionit" sh.a Ferizaj

NGA: Kuvendi i Komunës Kaçanik, Kemal Murseli-Kryesues i Kuvendit

Lënda: Kërkesë për takim urgjent për çështjen e menaxhimit të ujit

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 31.07.2024, diskutoj për gjendjen aktuale të furnizimit me ujë në komunën e Kaçanikut dhe shfrytëzimi i aseteve të finacuara nga buxheti komunal dhe donatorët për nevojat e rrjeteve të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU "Bifurkacioni"-Njësia e Kaçanikut.

I ftuar në këtë takim nga KRU "Bifurkacioni" sh.a, ishte Kryeshefi Ekzekutiv Jeton Shabani, por nuk mori pjesë.

Me qëllim të trajtimit të çështjes së menaxhimit të ujit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në këtë mbledhje doli me një: Kërkesë për takim urgjent për çështjen e menaxhimit të ujit

Takimi do të mbahet në mes të

- **Menaxhmentit dhe Bordit udhëheqës të KRU "Bifurkacionit" sh.a;**
- **Shefave të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut; dhe**
- **Përfaqësuesve të ekzekutivit të komunës së Kaçanikut**

Tema të takimit:

- Gjendja aktuale e furnizimit me ujë të pijshëm në komunën e Kaçanikut dhe shfrytëzimi i aseteve të finacuara nga buxheti komunal dhe donatorët për nevojat e rrjeteve të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU "Bifurkaioni"-Njësia e Kaçanikut.

Takimi u kërkua të zhvillohet urgjentisht brenda kësaj jave në objektin e Administratës komunale në Kaçanik ose në objektin e KRU "Bifurkacioni"-Ferizaj.

Kërkesa për takim urgjent, do të përcjellët përmes drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani, i cili do të kontaktet për ditën, kohën dhe lokacionin e mbajtjes së takimit.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



KAÇANIKU



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	29.07.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	
			Shtojcë	
		07	104/02-176827.	

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

INFORMATË RRETH INVESTIMEVE NË PROJEKTE TË UJËSJELLËSIT- KOMUNA E KAÇANIKUT 2020-2024



Drejtori

Ramadush Osmani

Raporti përmbledhës i investimeve nga komuna e Kaçanikut përmes të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim të njoftoj kuvendin komunal si dhe informimin e opinionit publik rreth investimeve kapitale të implementuara nga buxheti komunal dhe donatorëve në projekte të ndryshme të rrjeteve të ujësjellësit 2020-2024.

I. UJËSJELLËSI 2020

Investime nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH-ja).

1. Është finalizuar projekti “Sanimi, rekonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në shtimin ekzistues të ujësjellësit për fshatrat Dubrave, Rekë, Nikaj, Soponicë, Doganaj, Elezaj, Koxhaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër, projekt i financuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH-ja).

Vlera totale e projektit=1,219,358.70€

- Në kuadër të projektit “**Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit**”-2020 shuma totale **46,396.25€** nga buxheti i komunës është investuar në këto lokalitete:

Nr.	Emërtimi
1	Në kuadër të projektit “ Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit ” është vendosur gypi nga lagjja Beljan deri te restorant Shqiponja –Provoli në gjatësi 2300m
2	Furnizimi dhe vendosja e gypit të ujësjellësit në rrugën “ Avdurrahim Shehu ” në gjatësi 1600m (Ø160 =800m dhe Ø110 =800m).
3	Në kuadër të projektit “ Ndërtimi i rrugëve të qytetit ” dhe “ Rregullimi i rrugës “Idriz Seferi ” është bërë ndërtimi i gypave të rrjetit të ujësjellësit nga materiali i asbestbetonit me gypa polietileni në gjatësi 349.5m (Idriz Seferi) dhe 250m (në rr.Agim Bajrami).
4	Po ashtu në bashkëpunim me KRU “Bifurkacioni”-njësia operative në Kaçanik është shtrirë dhe funksionalizuar rrjeti i ujësjellësit në lagjen Kukaj-Bob dhe Mezraj-Kovaqec.
5	Janë siguruar 8300m gyp Ø63 për nevojat e rrjetit të ujësjellësit në komunë(fshatin Duraj dhe Kovaqec) si dhe janë siguruar gyp ujësjellësi Ø315 =800m dhe Ø110 =2000m për nevojat e rrjeteve aktuale të ujësjellësit

II. UJËSJELLËSI 2021

- Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit”, projekt i listuar në listën e investimeve kapitale të vitit 2021 në shumë totale **108,575.31€** nga buxheti i komunës së Kaçanikut është realizuar në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshenuar.

Nr.	Emërtimi
1	Shtimi i kapacitetit të ujit në Dubravë-Doganaj-Elezaj (1 burim dhe 1700m rrjet primar)
2	Aktivizimi i rezervuarit 1000m ³ dhe vendosja e 800m rrjet tëri Φ 315 nga rezervuari deri te Halla e Sportit
3	Shtim i kapacitetit të ujit në Gllboqicë (4 burime dhe 2300m rrjet primar)
4	Shtim i kapacitetit te ujit në qytet (aktivizimi i pompës nga pusi te ish fabrika e Gelqeres)
5	Vendosje e gypit Φ 63 për lagjen Smokaj-Begracë (1000m rrjet /rezervuar-lagje Smokaj
6	Permes projektit” Rehabilitimi i rruges “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra” është ndërruar rrjeti ekzistues i ujësjellësit nga materiali asbestbeton ne material polietilen $\text{Ø}200$ L=660m si dhe është vendosur gypi $\text{Ø}63$ për kyqjet shtepiake në të dy anët e rrugës L=875m
7	Punimi i murit rrethues te peshorja e ujit në Sepetin-Dubravë h=1.80m
8	Furnizim me gyp për nevoja të sistemi të ujësjellësve <ul style="list-style-type: none">• Φ 75=4500m• Φ 50=2000m• Φ 110=2000m

III. UJËSJELLËSI-2022

- Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit” i listuar në listën e investimeve kapitale për vitin 2022 në shumë totale **198,569.27€** është realizuar në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshënuar.

Nr.	Emërtimi
1	Rehabilitimi i objektit të pusit dhe shtrirja e rrjetit të ujësjellësit te “Fabrika e Gëlqeres” –Kaçanik
2	Ndërtimi dhe shtrirja e rrjetit të ujësjellësit /segmenti Stacioni i Pompimit në Koxhaj deri Silcapori
3	Ndërtimi i rezervuarit akumulues dhe shtëpizës së Stacionit të Pompimit-Koxhaj.
4	Sanimi i rrjetit të ujësjellësit ekzistues /segmenti Silcapor-te Lushi-lumi Lepenc-Sepetin.
5	Rehabilitimi dhe sanimi i rrjetit të ujësjellësit /segmenti rezervuari i lagjes Topalli-Varrezat e Dubravës.
6	Punimet dhe pastrimi i rezervuareve në Sepetin-Rekë-Topall dhe Soponicë.
7	Punimi i kaptazhës dhe odës kontrolluese në Rekë të Dubravës.
8	Ndërtimi i rezervuarit $V=250m^3$ në fshatin Ivajë
9	Vazhdim i rrjetit të gypsjellësit nga burimet për fshatin Glloboqicë. $L=2600m$
10	Shpimi i pusit me rrotacion në fshatin Koxhaj dhe punimet e pusetës kontrolluese
11	Vendosje e rrjetit të ri të ujësjellësit në rr.”Xhevdet Guri”-fshatin Nikaj

Poashtu përmes projektit “Furnizimi me gypa për rrjetet e ujësjellësit” është siguruar sasia e gypave dhe profileve që do të përdoren në vijim për nevojat e rrjeteve të ujësjellësve ne komunën e Kaçanikut.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m
	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 110 për nevoja të rrjetit të ujësjellësëve	1500m
	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 90 për nevoja të rrjetit të ujësjellësëve	1400m
	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 75 për nevoja të rrjetit të ujësjellësëve	1000m
	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63 për nevoja të rrjetit të ujësjellësëve	1000m
	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 50 për nevoja të rrjetit të ujësjellësëve	600m
	Totali	5500m

IV. UJËSJELLËSI 2023

- Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit” nga lista e investimeve kapitale 2023 në shumë totale **144,941.60€** është realizuar në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshënuar.

Nr.	Emërtimi
1	Rrjeti i ujësjellësit në Bajnicë (stacioni i pompimit dhe rrjet ujësjellësi L=670m)
2	Rrjeti i ujësjellësit në Ivajë-faza II-të (rrjeti primar L=6020m)
3	Rrjeti i ujësjellësit në rr "Reshat Shehu" dhe “Selim Shehu”- Kaçanik L=585m
4	Shpimi i pusit të ri me rotacion në thellësi 120m - K. Vjetër (afër Ballkan Petroll-it)
5	Vazhdimi i rrjetit të ujësjellësit në rr.”Dëshmorët e Kombit”-Dushkajë Φ 63 (L=600m)
	Furnizim me gyp për nevoja të sistemi të ujësjellësve
	<ul style="list-style-type: none">• Φ 75=1000m• Φ 63=1800m

V. UJËSJELLËSI 2024

- Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit”- 2024 është planifikuar të implementohet në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshënuar. Pritet të lidhet kontrata brenda javës dhe të fillohet me realizimin e punimeve në tëren. Vlera e kontratës është **41,988.43€**.

Nr.	Emërtimi
1	Ndërtimi dhe punimi i kaptazhës së ujit dhe odës akumuluese “Te Mrizi”-Ivajë e Vjetër si dhe shtrirja e gypit furnizues 1800m $\text{Ø}110$ deri te rrjeti kryesor i qytetit
2	Vazhdimi i rrjetit primar furnizues i ujësjellësit deri te rezervuari i ri i fshatit Ivajë 600m $\text{Ø}75$
3	Shtrirja e rrjetit sekondar të ujësjellësit në rr.”24 Marsi”-Ivajë
4	Punimi dhe depërtimi i gypit kryesor nën linjën hekurudhore te Ura e Konakut në Kaçanik

	STATISTIKA 2020-2024	Vlera investive
	Investime nga MMPH-ja	
I.	Projekti "Sanimi, rekonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në sitemin ekzistues të ujësjellësit për fshatrat Dubrave, Rekë, Nikaj, Soponicë, Doganaj, Elezaj, Koxhaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër	1,219,358.70€
	Totali I	1,219,358.70€
II.	Investime nga buxheti i komunës 2020-2024	
1	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit 2020	46,396.25€
2	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit 2021	108,575.31€
3	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit 2022	198,569.27€
4	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit 2023	144,941.60€
5	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit 2024	41,988.43€
	Totali 1+2+3+4+5	540,470.86€
	Totali I dhe II	1,759,829.56€

Raporti u përpilua nga:

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Drejtor i DSHPE-së

 Ramadush Osmani